KËRKESË
Nr. 1909, datë 4.4.2017

PËR SHPRONËSIM
PËR INTERES PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën, "Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga zbatimi i projektit "Riveshje-sistemim-asfaltim-masa inxhinierike, rruga Këlcyrë-Përmet (Loti 3)", për pasuritë e llojit "pyll".

Subjekti kërkues, i këtij objekti, është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni, konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik" i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit "pyll". Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik".

Vlera totale e shpronësimit është **740 500** (**shtatëqind e dyzet mijë e pesëqind**) **lekë**.

ZËVENDËSMINISTËR I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Bahri Shaqiri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "RIVESHJE-SISTEMIM-ASFALTIM-MASA INXHINIERIKE, RRUGA KËLCYRË-PËRMET (LOTI 3)"

Nr.	Pronari			Z.K.	Nr.pas	Lloji i pasurisë	Sip.totale (m^2)	Sip. e shpronësimit (m^2)	Çmimi (lekë/m 2)	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Bashkëpronarët		Haxhiaj	2330	53/1	pyll	15000	7405	100	740500	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
SHUMA TOTALE										**740500**	